




Pasqyra Makroekonomike publikohet nga Ministria e Financave çdo tre muaj dhe ka për qëllim informimin mbi zhvillimet tremujore ekonomike në Kosovë.

Sektori Real

Ekonomia vendore pritet të rritet me rreth 4.6% përgjatë vitit 2018, në terma real. Rritja ekonomike do të vazhdoj të jetë e nxitur kryesisht nga të njëjtët shtytës (investimet, eksporti, konsumi privat, eksporti), mirëpo investimet publike dhe private pritet të kenë rol më të theksuar në rritjen e BPV-së. Kontribut të veçantë në këtë rritje të aktivitetit ekonomik vlerësohet të ketë ardhur nga reformat fiskale si dhe reformat strukturore të ndërmarra përgjatë periudhës paraprake. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (shih grafikun 1), BPV në tremujorin e parë të vitit 2018 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka shënuar rritje prej 3.5% ne terma real, ndërsa viti 2017(sipas të dhënave preliminare të ASK-së) në krahasim me vitin 2016 ka shënuar rritje vjetore në vlera reale prej mbi 3.7%.


Grafiku 1. BPV reale, sipas qasjes së shpenzimeve



Përgjatë periudhës raportuese, indeksi i çmimit të konsumatorit (IÇK) ka filluar të tregoj tendencë rritëse, kjo si rezultat i fillimit të ngritjes së çmimeve botërore të ushqimit dhe transmetimi i këtyre presioneve inflacioniste në vend,

veçanërisht gjatë muajve Maj-Qershor. Niveli i përgjithshëm i çmimeve gjatë kësaj periudhe shënoi rritje prej 0.7% siç mund edhe të shihet edhe nga grafiku 2. Tendenca në rritje vazhdon edhe gjatë periudhës së mbetur të vitit në 2018.

Grafiku 2. Indeksi i Çmimit të Konsumatorit




Si tregues i rëndësishëm i zhvillimeve të ekonomisë në vend u referohemi treguesve si numri i bizneseve të reja të regjistruara dhe përceptimet e bizneseve për ambientin e përgjithshëm biznesor. Nga të dhënat e ASK-së (Tabela 1) vërejmë se në Kosovë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018 u regjistruan gjithsej 2,636 biznese të reja, Që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë 399 biznese të reja të regjistruara më shumë, ndërsa gjatë kësaj periudhe janë çregjistruar 412 biznese apo 32 biznese më pak se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Inkurajues është fakti i rritjes së biznese të reja të të gjithë sektorët, përveç tek sektori akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim, ku është numër pothuajse i njëjtë me vitin e kaluar. Gjatë periudhës raportuese bizneset me numër më të madh të regjistruara mbeten në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, Bujqësi, pylltari dhe peshkatar, prodhim dhe ndërtimtari .

Tabela 1. Numri i bizneseve të regjistruara

Sektori i regjistrimit të biznesit	TM2 2017	TM2 2018
Tregti me shumicë dhe pakicë	623	723
Prodhim	234	299
Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	96	198
Ndërtimtari	202	260
Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	278	277
Të tjera	804	879
Totali	2,237	2,636

Pasi që pritjet dhe vlerësimet e bizneseve vendore mbi pritjet ekonomike dhe të bërit biznes janë tregues të rëndësishëm për ecuritë ekonomike, në vijim janë të paraqitura të dhënat nga Oda Ekonomike e Kosovës¹ të cilat pasqyrojnë pozitën e sektorëve sipas vlerësimeve të bizneseve.


Grafiku 3. Klima e biznesit në TM1 2017



Të dhënat e tremujorit të parë të vitit 2017 dhe 2018 tregojnë se përshtypjet e shumicës së bizneseve lidhur me klimën e të bërit biznes kanë qenë pozitive. Megjithatë, kjo nuk vlen edhe për sektorin e shitjes me shumicë dhe ndërtimtarisë të cilat në këtë tremujor janë të rreshtuara në klimë pozitive por me përkeqësim. Sektori i përpunimit, shitjes me pakicë dhe i shërbimeve, paraqesin përmirësime në pritshmëritë e tyre dhe vlerësime të tilla mund të vijnë për shkak të fillimit

të sezonës së pranverës e cila ka ndikim tek sektorët e ndryshëm në përgjithësi.


Grafiku 4. Klima e biznesit në TM1 2018



Grafiku 5. Na prezanton pritjet e bizneseve mbi klimën që do të mbizotërojë për gjashtë muajt në vijim. Përshtypjet e bizneseve lidhur me klimën e të bërit biznes janë me disa ndryshime me pritjet mbi klimën që do të mbizotërojë për muajt e ardhshëm.

Vlen të theksohet se në përgjithësi pritshmëritë e bizneseve janë pozitive por në kufi të asaj me përkeqësim dhe përmirësim, përveç sektorit të ndërtimtarisë e cila pritshmëritë i ka pozitive me përmirësim për sa i përket klimës që do të mbizotërojë në 6 muajt e ardhshëm.

Grafiku 5. Pritjet e bizneseve në TM1 2018 për gjashtë muajt e ardhshëm



¹ Raporti "Gjetjet e klimës së biznesit kosovar në tremujorin e dytë 2018" nuk është i përditësuar nga OEK.

Bilanci i tregtisë së jashtme vazhdon të mbaj trendët negativ. Importi i mallrave edhe gjatë tremujorit të dytë ka vazhduar të ketë trend rritës, ku përgjatë periudhës prill-qershor në raport me periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm, ka shënuar rritje prej 12.7%. Tabela 2, tregon katër grupe produktesh që përbëjnë më shumë se gjysmën e importeve gjatë periudhës TM2.

Tabela 2. Importi sipas produkteve, në '000 euro

Kategoria	TM2 2017	TM2 2018
Ushqime të përg. pije dhe duhan	101,423	104,016
Produkte minerale	107,164	121,607
Metale bazë dhe artikuj prej tyre	80,683	100,639
Makineri, pajisje makinerie e elektrike	93,730	132,756
Të tjera	403,915	427,655
Totali	786,915	886,673

Në tabelën 3. Paraqitet struktura e importeve sipas shteteve, të dhënat e importit sipas shteteve na tregojnë se rreth 44% e importit total vjen nga shtetet e Bashkimit Evropian. Ndërsa, vendet me pjesëmarrje më të lartë të importit janë Gjermania, Sërbia, Turqia dhe Kina. Sa i përket importit nga Gjermania, ai ka shënuar rritje në këtë tre mujor prej 22.5%, si dhe nga Turqia me rritje prej 12.5% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa vërehet rënie të importit nga Kroacia prej 12.6%, në TM2 2018 krahasuar me TM2 2017.

Tabela 3. Importi sipas shteteve, në '000 euro

Shteti	TM2 2017	TM2 2018
Gjermania	95,386	116,832
Italia	48,443	62,861
Sërbia	107,785	113,879
Turqia	83,261	93,695
Kina	67,845	72,957
Të tjera	384,197	426,450
Total	786,915	886,673

Sa i përket eksporteve gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018 ato kanë shënuar rënie në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm. Eksportet e mallrave gjatë kësaj periudhe arritën vlerën mbi 95.4 milionë euro, që në përqindje shënon rënie prej rreth 7.3%.

Tabela 4. Eksportet sipas produkteve, në '000 euro

	TM2 2017	TM2 2018
Produktet minerale	24,113	20,380
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	33,814	26,500
Plastika, goma dhe artikujt prej tyre	8,925	11,388
Të tjera	36,057	37,203
Total	102,910	95,472

Nga tabela 4. Shohim se ka rënie të dukshme në eksportet e metaleve bazë dhe produkteve minerare prej 22% dhe 15%, respektivisht. Përderisa gjatë këtij tremujori shohim se ka rritje prej 28%, në eksportin e produkteve të plastikës dhe gomës dhe produkteve minerale. Rreth 85% e eksporteve kosovare u destinuan në shtetet e CEFTA-s dhe të BE-së.

Tabela 5. Eksporti sipas shteteve, në '000 euro


Shteti	TM2 2017	TM2 2018
Gjermania	4,829	5,617
Italia	1,329	2,208
Bullgaria	2,605	2,364
Shqipëria	15,958	16,973
Maqedonia	13,199	12,189
Sërbia	15,629	11,276
India	12,676	758
Kina	1,616	441
Te tjera	35,069	43,646
Total	102,910	95,472

Nga tabela 5. shihet rënie në eksport me vendet India, Sërbia dhe Kina. Mirëpo, vërehet rritje e eksportit në Gjermani, Itali dhe Shqipëri, ndërkohë që vendet e CEFTA-s edhe më tutje

vazhdojnë të mbesin partnerët kryesor për eksportin e mallrave. Duke pasur parasysh pjesëmarrjen dominuese të metaleve në eksportin kosovar, rënia e eksportit të këtij produkti vazhdon të ndikojë dukshëm eksportin total, prandaj shohim një rënie prej rreth 7% në eksportin total edhe për këtë periudhë.

Në anën tjetër bilanci i shërbimeve edhe gjatë muajve Prill-Maj 2018 (pasí që ende nuk kemi të dhëna për muajin Qershor, krahasimi do të bëhet me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar) eksporti i shërbimeve ka vazhduar rritjen në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjithashtu edhe importi i shërbimeve krahasuar me periudhën e njëjtë është rritur për rreth 14%.


Grafiku 6. Bilanci tregtar



Sektori Fiskal


Të hyrat e përgjithshme buxhetore tregojnë një ngritje në tremujorin e dytë të vitit 2018 krahasuar me atë të kaluar në periudhën e njëjtë. Kjo ngritje shënon normën prej 5.9%, ku të hyrat nga tatimet direkte janë për 15.5% më të larta kurse ato Indirekte për 5.6%. Kjo ngritje në arkëtim vjen si rrjedhojë e aktivitetit të shtuar ekonomik në vend, rritjen e vëllimit të shpenzimeve të sektorit privat dhe publik, përmirësimin e ambientit të të bërit biznes dhe efijencës së agjencive mbledhëse si rezultat i reformave strukturore.

Grafiku 7. Të hyrat, në milionë euro




Ndërkaq, sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, ato gjithashtu shënuan një ngritje prej 4% në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. një ngritje më e theksuar shihet tek shpenzimet rrjedhëse me 5.6%, ndërsa ato kapitale janë në ritmin dhe dinamikën e njëjtë me atë të vitit të kaluar.

Grafiku 8. Shpenzimet, në milionë euro



Si rrjedhojë e ngritjes së shpenzimeve për këtë periudhë, deficiti primar sipas grafikut me poshtë tregon se është shënuar një rritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Grafiku 9. Deficiti Primar, në milionë euro



Sektori Financiar

Sektori financiar në Kosovë vazhdon të mbetet mirë i kapitalizuar, likuid dhe profitabil. Kjo vë re rezultate të përforsimit të procedurave konservative ndaj riskut kreditor. Duke u bazuar në të dhënat nga Banka Qendrore e Kosovës, depozitat shënuan një rritje prej 5.7% në raport me periudhën e njëjte të vitit paraprak. Në anën tjetër, rritja e kredive ishte edhe më e madhe, duke arritur normën prej 10.8%. Asetet totale shënuan rritje prej 5.2%, duke arritur në 3.89 miliardë euro në fund të periudhës raportuese.

Tabela 6. Depozitat dhe kreditë në sektorin financiar, kumulative, fundi i periudhës (në milionë euro).

	TM2 2017	TM2 2018
Depozitat	2,888	3,086
Kreditë	2,391	2,661
Asetet Totale	3,671	3,891


Trendi i rënies së normës së interesit të kredive të reja, vazhdoi edhe përgjatë tremujorit të dytë të vitit 2018, ku nga 6.7% në tremujorin e dytë 2017, normat kanë rënë në 6.66% në tremujorin e dytë 2018. Ndryshim pozitiv shënoi edhe norma e interesit të depozitave të reja. Ajo shënoi rritje nga 1.0% në tremujorin e dytë 2017 në 1.24% në tremujorin e dytë 2018. Sipas të dhënave statistikore të Bankës Qendrore të Kosovës, sektori financiar vazhdon të mbetet një kontribues i rëndësishëm në financimin e ekonomisë së vendit.

Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2017, në tremujorin e dytë 2018, kreditë shënuan rritje të përcjellura nga depozitat të cilat gjithashtu shënuan rritje. Ndryshime të tilla janë indikatorë të mirë që sektori bankar vazhdon të mbetet mirë


i kapitalizuar. E tërë kjo si rezultat i përpjekjes për të ndjekur politikën e reformave të vazhdueshme për stabilitet makroekonomik dhe zhvillim financiar. Në grafikun 11, janë të paraqitura zhvillimet e depozitave dhe kredive ku trendi rritës është i dukshëm.

Normat e interesit të kredive të reja shënuan rënie gjatë tërë vitit 2017, krahasuar me vitin paraprak 2016. Norma mesatare shënoi rënie nga 7.47% në 6.83% përgjatë viteve 2016 dhe 2017. Në anën tjetër, norma e interesit tek depozitat e reja gjatë vitit 2017 shënoi një ngritje prej 0.03 pikë të përqindjes; nga 1.01% në 2016 në 1.04% në vitin 2017.

Grafiku 10. Trendi i normave të interesit dhe depozitave



Grafiku 11. Trendi i kredive dhe depozitave



Tabelë përmbledhëse

Përshkrimi	Njësia	2015	2016	2017				2018	
				TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2
SEKTORI REAL									
Bruto Produkti Vendor	çmime konst., ndryshimi në %	4.0	3.9	2.7	4.3	4.4	3.2	3.5	:
IÇK	ndryshimi në %	-0.5	0.3	1.6	1.9	1.7	0.7	0.0	0.7
Ushqimi dhe pijet	ndryshimi në %	0.4	-0.4	1.0	1.9	1.4	1.9	0.6	0.5
Çmimet e importit	ndryshimi në %	-1.2	-2.5	5.2	4.3	4.2	2.5	1.4	:
Çmimet e prodhimit	ndryshimi në %	2.7	-0.1	0.9	5.5	5.6	1.6	0.2	:
TREGU I PUNËS									
Norma e punësimit	ndryshimi në %	25.2	28.0	28.9	29.9	30.4	29.8	28.8	:
Norma e papunësisë	ndryshimi në %	32.9	27.5	30.5	30.6	30.2	30.6	26.5	:
Numri i bizneseve të regjistruara		9,833	10,424	2,861	2,266	2,241	1,951	2,587	2,657
Numri i bizneseve të ç'regjistruara		2,205	2,360	429	444	298	417	486	412
SEKTORI I JASHTËM									
Importi i mallrave	c.i.f., mil. euro	2635	2790	609	787	821	830	656	887
Eksporti i mallrave	f.o.b., mil. euro	325	310	76	103	105	94	73	96
Bilanci tregtar	mil. euro	-2309	-2480	-533	-684	-716	-736	-582	-791
Importi i mallrave dhe shërbimeve	mil. euro	2926	3091	665	853	953	899	729	629*
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	mil. euro	1274	1439	235	305	874	296	270	200*
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	mil. euro	-497	-481	-168	-250	238	-233	-154	-202*
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	% e BPV	-8.6	-7.9	-2.7	-4.0	3.8	-3.7	-8.4	:
Investimet e Huaja Direkte	bilanci, mil. euro	309	220	65	84	66	74	31	46*
Remitancat	bilanci, mil. euro	609	636	149	183	183	194	170	137*
SEKTORI FISKAL									
Të hyrat e përgjithshme prej të cilave:	mil. euro	1457	1596	354	415	476	436	368	439
Të hyrat nga tatimet direkte	mil. euro	198	232	57	62	60	59	63	71
Të hyrat nga tatimet indirekte	mil. euro	1107	1227	253	321	380	361	262	339
Shpenzimet e përgjithshme prej të cilave:	mil. euro	1551	1658	349	421	422	549	407	434
Shpenzimet rrjedhëse	mil. euro	1149	1221	286	315	296	386	320	332
Shpenzimet kapitale	mil. euro	404	444	56	103	121	191	81	102
SEKTORI FINANCIAR									
Depozitat	mil. euro	2703	2898	2912	2888	3047	3093	3074	3086
Kreditë	mil. euro	2020	2230	2295	2391	2407	2485	2534	2661
Asetet totale të sektorit financiar	mil. euro	3385	3637	3670	3671	3811	3876	3873	3891
Norma e interesit në kredi	%	8.3	7.5	7.3	6.7	6.6	6.8	6.9	6.7
Norma e interesit në depozita	%	0.9	1.01	0.9	1.0	1.1	1.1	1.1	1.2
Norma e këmbimit	EUR/EUR	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0
Norma reale efektive e këmbimit	indeks	104.7	104.6	105.9	104.6	104.8	104.5	104.9	104.4

Burimet: Agjencia e Statistikave të Kosovës
Banka Qendrore e Kosovës
Thesari i Kosovës (Ministria e Financave)
Oda Ekonomike e Kosovës

(:) – nuk ka të dhëna; në këto raste, të dhënat janë të disponueshme vetëm për tremujorin si tërësi * të dhënat përfshijnë periudhën Prill-Maj, pasi që në kohën e publikimit të kësaj Pasqyre, nuk janë të publikuara të dhënat për muajin Qershor/Diskrepancat e mundshme me publikime tjera të Njësive vijnë si pasojë përpunimit të të dhënave nga BQK, pasuar edhe me revidim historik.

Përdorimi i të dhënave nga ky publikim lejohet vetëm me citimin e burimit. Pasqyra publikohet çdo tremujor dhe çdo përmirësim bëhet në faqen zyrtare në internet. Për çdo dallim mes versioneve, mbizotëron ai në gjuhën shqipe.

Departamenti për Politika Makroekonomike dhe
Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar
Njësia e Makroekonomisë
Gusht 2018